# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-469401**
VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | U sulmua me vezë në New York, reagon Rama: Flamurin shqiptar e kam ngritur më shumë se kurrë para botës, pulat histerike që çarten rrugëve ta mbajnë vath në vesh se… \| Top Albania Radio |
| ADRESA | `https://www.topalbaniaradio.com/u-sulmua-me-veze-ne-new-york-reagon-rama-flamurin-shqiptar-e-kam-ngritur-me-shume-se-kurre-para-botes-pulat-histerike-qe-carten-rrugeve-ta-mbajne-vath-ne-vesh-se/` |
| BURIMI | topalbaniaradio.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 25 shtator 2026, 15:30:14 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 25 shtator 2026, 15:28:28 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `c21f22d018a37645927c634d0cde4274ae319c13c7ed11b6780014ea1db7d763` |
| TEKSTI | `4c12af3517200bb5ba3dc48b5cb2376075273d822ae71f2222c70e6b25523853` |
| PAMJA | `2d1a82421ca14204a019f7d752af179f61276083b52daeb6592f0d49b8d22a5e` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `815d7f26c0fdb4368d0ff8dedfcc23fc2224d2d40039be4f4baa9b76ca089550` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `77d68db3023b2e51e8611bf6d5eddb24bf36cfc38da7912fff4d1353a313a25f` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/815d7f26c0fdb4368d0ff8dedfcc23fc2224d2d40039be4f4baa9b76ca089550`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Bota

# U sulmua me vezë në New York, reagon Rama: Flamurin shqiptar e kam ngritur më shumë se kurrë para botës, pulat histerike që çarten rrugëve ta mbajnë vath në vesh se…



*Edi Hallaci*

*25 Shtator 2026*




Kryeministri Edi Rama ka reaguar pas sulmit me vezë që i bënë disa protestues gjatë vizitës së tij në Nju Jork, ku do të marrë pjesë në Asamblenë e Përgjithshme të OPKB-së.

Në një postim në X, kryesocialisti shprehu se "e ka ngritur flamurin shqiptar më shumë se kurrë para syve të botës" ndërsa shtoi se ai nuk do të mposhtet me "bombat çudibërëse" që amplifikojnë në kupë të qiellit ditë e natë fjalën korrupsion.

"Këtyre që mbulohen me flamurin kombëtar dhe çarten rrugëve si pula histerike, u them vetëm se atë flamur e kam ngritur më lart se çka qenë kurrë ndonjëherë në sytë e botës. Kurse atyre që kujtojnë se do më ndalin me baltë, vezë dhe jargë, në misionin tim për ta çuar flamurin tonë në majën e Europës së Bashkuar, u them se nëse për herë të parë në historinë e shtetit shqiptar, kemi një sistem institucional që shfaq aftësi vetëpastrimi, kjo është një arritje e madhe që nuk ka rënë nga qielli po ka ardhur pikërisht si një nga rezultatet e këtij misioni!

Dhe le ta dëgjojnë e ta mbajnë mirë vath në vesh meqë kujtojnë se mposhtem unë dot me "bombat çudibërëse" që amplifikojnë në kupë të qiellit ditë e natë fjalën korrupsion:

Në një vend që është i mbytur në kënetën e korrupsionit, nuk ka luftë frontale e as rezultate konkrete kundër korrupsionit dhe atë vend e kemi jetuar ne, që të gjithë, deri kur unë me partinë time e kthyem rrotën e drejtësisë nga barazia e të gjithëve para ligjit!

Sot Shqipëria nuk është më ai vend e prandaj edhe Bashkimi Europian e çmon gjithnjë e më shumë Shqipërinë për këtë luftë, ndërkohë që pulat histerike të katundit tonë kakarisin e hedhin vezë në

ajër për llogari të gjelave tallagjare të pazarit politik e mediatik, të cilët i gënjen mendja sa një vezë, se do të më ndalin mua me llogjet e pafundme për korrupsionin që po luftohet nga vetë sistemi që po ndërtojmë, apo me sharjet e mallkimet folklorike si të këtij sqepit bashkëngjitur, që e shkruan shqipen me këmbët e pulës", tha Rama.

## LAJME TË NGJASHME




Gjimshiti para Shqipëri-Bjellorusi: Synojmë të shkojmë për herë të tretë në Europian

1.5 MIN



Rama në Këshillin Europian të Korporatave: Paqja, kusht për zhvillimin ekonomik!

1 MIN




Skandali i SHISH, Boçi: Ka përgjegjësi politike dhe institucionale, Rama të vijë me dorëheqjen

2.5 MIN




"Rama të japë dorëheqjen"/ Berisha për ish-kreun e SHISH: Hyseni ishte përgjegjëse direkt para Kryeministrit

2.5 MIN



BE importon nga Kina tre herë më shumë sesa eksporton, "The Guardian": Deficiti tregtar arriti në 36.5 mld euro në korrik

2.5 MIN

## MË TË LEXUARAT



Arrestohet Susan Sarandon/Protestoi kundër Netanyahu-t në OKB!



Lonely Planet zbulon destinacionet më të mira për 2027-ën!



Nations League, Kosova debuton me fitore!



Italia ndalon burkën në shkolla/Kufizime edhe për nxënësit e huaj në klasa!



Parada Seksi e Yjeve: kush do të digjet nga dashuria këtë fundjavë!



Si i jep fund marrëdhënieve secila shenjë e zodiakut!



55-vjeçarit i nxjerrin nga barku ngjalën e gjallë pas një dite!



Në këtë vend mendojeni dy herë para se të dëgjoni muzikë me zë të lartë, do të gjobiteni!



Agim Ademi, mesazh emocionues pas fitores së "Dardanëve"!



Rama në Këshillin Europian të Korporatave: Paqja, kusht për zhvillimin ekonomik!

## EDITORI SUGJERON



"Një politikan, vajza e Alfred Cakos dhe…"/ Bledi Mane zbulon banorët e këtij sezoni të BBV?



A vazhdon të jetë i virgjër? At Nikolla Xhufka tregon si vepron kur përballet me tundimet seksuale: Edhe tani me vajza të bukura…



"Më bezdis përndjekja..."/Ina Aderi: Më kanë ngacmuar personazhe, do dashurohem larg kamerave...




Kuqezinjtë nisin misionin e ri në Nations League, të gjitha emocionet live dhe ekskluzivisht në DigitAlb!



Pse na mungon dikush më shumë gjatë natës? Ja çfarë mund të fshihet pas kësaj ndjesie...



Mund t'u mungosh shumë, por mesazhin mos e prit! 3 shenjat e horoskopit që nuk bëjnë kurrë hapin e parë...



Fenomeni "pocketing"/ Kur partneri të mban sekret dhe askush në jetën e tij nuk e di që ekziston...



Pse disa njerëz ecin nëpër shtëpi ndërsa flasin në telefon? Arsyeja pse e bëjnë këtë pa e kuptuar është...



"Goca dhe Gra" rikthehet në ekranin e Top Channel me ndryshime, kush janë moderatoret e sezonit të ri?



"Vetëm 1.8 kg, dyditëshe dhe…"/ Prof. Dr. Altin Veshti zbulon operacionin e jashtëzakonshëm në zemër që ka kryer!

**RRETH NESH**

Top Albania Radio promovon muzikën më të zgjedhur shqiptare dhe të huaj, me edicionet informative dhe një larmi programesh kulturore. 27 vjet transmetim, për të dhënë më të mirën.

**KONTAKT**

Address: Sheshi Italia 1, Arena Center, Tirana, Albania
Email:
[email protected]

Tel: +355 69 208 0500
+355 69 442 8873

**COPYRIGHTS**

Përmbajtja e këtij website është pronë e Top Albania Radio. Kopjimi, përdorimi apo riprodhimi i paautorizuar i tij, përbën shkelje penale.

**LINKS**

- Kontaktoni
- Marketing
- Frekuencat
- Aksesueshmëria
- Mundësi Punësimi
- Privacy Policy & Terms

JavaScript is required for tabnav widget to work properly.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.